



P

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 47, datë 21.05.2024

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.3, DATË 6.02.2024
“PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITHSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA KU
DO TË USHTROHET VEPRIMTARIA SI STACION PLAZHI, PLAZHET PUBLIKE PËR
VITIN 2024 SI DHE PLOTËSIMIN E SAJ ME ELEMENTËT E NEVOJSHËM LIDHUR
ME STANDARTET E KËRKUARA NGA AKTET LIGJORE NË FUQI”**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 43/2020, “Për aktivitetet e turizimit tregtar”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhërin nr. 364, datë 04.12.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**



1. Miratimin e një shtese në VKB nr.3, datë 06.02.2024 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara ku do të ushtrohet veprimtaria si stacion plazhi, plazhet publike për vitin 2024 si dhe plotësimin e saj me elementët e nevojshëm lidhur me standartet e kërkuara nga aktet ligjore në fuqi”, në lidhje me vendbazimet e mjeteve lundruese sipas hartës bashkëngjitur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 22.05.2024



Vendbazim përballë "Lura Hotel Mövenpick"





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 328/prot.
4

Durrës, më 29.05.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

BASHKIA DURRËS
29.05.24 05972/3

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.47 datë 21.05.2024 “Për një shtesë në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.3, datë 06.02.2024 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara ku do të ushtrohet veprimtaria si stacion plazhi, plazhet publike për vitin 2024 si dhe plotësimin e saj me elementët e nevojshëm lidhur me standartet e kërkuara nga aktet ligjore në fuqi”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

